



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E SUHAREKËS
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 054/2020

Nr. Protokolli: 107/2020

Për:	N.P.T.SH. Limit L & B Sh.p.k., Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN
Kopje:	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
Nga:	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
Lënda:	VENDIM
Datë:	25.09.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 16.09.2020 të parashtruar nga Operatorët Ekonomik: **N.P.T.SH. Limit L & B Sh.p.k., Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave”** me Nr. të Prokurimi: **624-20-2107-5-2-1& 624-020-025-521** nxjerr këtë:

V E N D I M

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 16.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **N.P.T.SH. Limit L & B Sh.p.k., Xheladin Hana nr.20, 20000, PRIZREN**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave”** me Nr. të Prokurimi: **624-20-2107-5-2-1& 624-020-025-521** Njoftim për Vendimin e AK –së, të datës 14.09.2020 të publikuar në platformen elektronike.
2. **Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 14.09.2020**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 16.09.2020, ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit “**Sinjalizimi rrugor dhe sistemi i unifikuar i adresave**” me Nr. të Prokurimi: **624-20-2107-5-2-1& 624-020-025-521** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës 14.09.2020 të publikuar në platformen elektronike

Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve ka vlerësuar drejt, konform Ligjit të Prokurimit Publik dhe RRUOPP duke analizuar dokumentacionin e nevojshëm të kërkuar sipas DT Pretendimet e juaj se OE i propozuar për fitues nuk përbush kërkesat nuk qëndroj, ngase kemi shikuar me kujdes dokumentacionin e ofruar nga OE i propozuar për fitues, ku dhe ju i posedoni keto dokumentacione te cilat keni kërkuar qasje ne dokumente publike në këtë procedur, ndersa tenderi juaj është refuzuar ngase nuk plotesoni kapacitetin teknik dhe profesional te kërkuar sipas dosje se tenderit, ku ju mungon deshmit mbi pasjen per makien për shenjezim horizontal (ku keni prezantuar nje makin, qe aktualisht ndodhet ne R.Maqedonis, dhe ne sqarimet shites te ofruar nga ju, pas kerkeses se AK-Suhareke, ju na sqaroni se jeni ne dispozicion qe me shpenzimet tuaj mundeni te na dergoni ne vend ngjarje per te pare paisjen, sepse dokumentacionin per te nuk po mundeni te gjeni.), e poashtu marrvjesha nuk është e lidhur për këtë projekt.

AK-Suharekë ka në dispozicion të gjitha faktet dhe dokumentet (E-mailiat) te ofruar nga ju dhe se konform dispozitave ligjore do ti prezantoj para çdo Organi aty ku paraqitet nevoja.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit
Arif BYTYQI

